



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.126/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Afiete Sada-Gllogjani dhe Nenad Laziq anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në hapësira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.10.2019, mori këtë:

### VE N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë me Anr. 126/2019 e datës, 29.09.2019, dhe Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 2,500.00 (dy mijë e pesëqind) euro, cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 29.09.2019, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 28 Shtator 2019 në orën 16:00, në rrugën “Nënë Tereza” të qytetit të Gjakovës, kanë vërejtur se aktivistët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), kanë vendosur tendë dhe një tavolinë me disa karrige duke bërë shpërndarjen e materialit zgjedhor propagandues.

Me këtë rast parashtresuesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 33 pika b) të LZP-së, dhe po ashtu shkelje e Rregullores Nr.13/2013. Parashtresuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur 3 fotografi të printuara.

Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik PDK, thekson se ankesa e paraqitur nga subjekti politik LVV, Anr.126/2019, e datës 29.09.2019 është e pabazë, ndërsa ka njoftuar panelin për marrjen e masave përmirësuese, ku ia ka bashkangjitur pëlqimin me shkrim nga Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Urbanizëm me anë të së cilës subjekti politik në fjalë i është dhënë pëlqimi për vendosjen e tendës.

dhe shtuan se për shkak të afatit të shkurtër nuk kanë mundur të plotësojnë përgjigjen me prova sepse Pëlqimi nga Kuvendi Komunal i Gjakovës ekziston.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

## **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se tendat me materiale zgjedhore të subjektit politik PDK, janë të vendosura në hapësirat publike-rrugë, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton “ *Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve*”..

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Në raport me pretendimet e dhëna në përgjigjen në ankesë ku subjekti politik PDK deklaroi se ankesa është e pa bazuar pasi ata kanë siguruar pëlqimin nga Komuna për vendosjen e tendës, PZAP vlerëson se pëlqimi i marr nga Komuna është pasi është vendosur tenda dhe se në kohën e paraqitjes së ankesës subjekti nuk ka poseduar me leje apo pëlqim, mirëpo fakti se subjekti ka siguruar pëlqimin merret si masë lehtësuese drejtë përmirësimit të shkeljes.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se veprimet e subjektit politik PDK, nuk mund të sanksionohen si shkelje të LZP-së, për arsye se vendosja e tendës në shesh dhe shfrytëzimin e hapësirës publike, është bërë me pëlqimin e Komunës së Gjakovës, Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që, me këto prova nuk do të ishin justifikuar veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 33 pika b) i LZP-së, si dhe neni 5 paragrafi 1 pika d) e Rregullës 13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ). Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së PDK-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë

për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij fillimisht ka mohuar shkeljet e supozuara, por ka ndërmarr masat drejtë përmirësimit sikurse është cek më lartë.

Paneli konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së urdhëroi subjektin politik PDK që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljet në afatin prej 24 orëve dhe nëse subjekti politik PDK, nuk vepron sipas urdhrit të panelit do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i , në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.126/2019 më datën 02.10.2019

**Kryesues i Panelit**

**Faton Ademi**



*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.*